

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1 Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria “Ujesjelles - Kanalizime Elbasan” sh.a (në vijim referuar si “Shoqëria”) është themeluar më datë 24 qershor 2014, me aksioner Bashkinë Elbasan me 100% të kapitalit. Shoqëria është e regjistruar si person juridik i tatueshem pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan me numër identifikimi të personit të tatueshem L43121201L.

Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është: Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhim dhe/ose blerja e ujit për plotesimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajnimit të ujrave të ndotura dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre.

Aksioner i vetëm i shoqërisë është Bashkia Elbasan e cila zotëron 100% të aksioneve. Kapitali i Shoqërisë është 2,145,432,331 lekë përbëhet nga 1 aksion me vlerë nominale të aksionit 2,145,432,331 lekë

Selia qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën Lagjja Brigada 17 Sulmuese, rruga Petraq Popa, ish konvikti i Shkolles "Onufri", (kati I), Elbasan, Shqipëri.

Organet drejtuese të Shoqërisë janë Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 përbëhet si më poshtë:

- | | | |
|----|-------------------|---------|
| 1. | Adi Qose | Kryetar |
| 2. | Leli Kaja | Anëtar |
| 3. | Aulona Bylykbashi | Anëtare |

Administrator i Shoqërisë është z. Leli Kaja.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2020 është 336 punonjës (31 dhjetor 2019: 333 punonjës). Numri mesatar i punonjësve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 332 punonjës (31 dhjetor 2019: 325 punonjës).

2 Bazat e përgatitjes dhe Deklarata e Përputhshmërisë

2.1 Deklarata e Përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (“BNSK”). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Detaje për politikat kontabël të Shoqërisë, janë përfshirë në Shënimin 3.

2.2 Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë

Këto pasqyra financiare, më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, janë përgatitur nga Shoqëria për herë të parë në përputhje me SNRF-të. Pasqyrat financiare të peridhave paraardhëse der më dhe duke përfshirë vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”).

Shoqëria ka përgatitur pasqyra financiare që përputhen me SNRF-të e zbatueshme në 31 dhjetor 2020, së bashku me të dhënat e periudhës krahasuese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, siç përshkruhet në përmbledhjen e politikave kryesore kontabël në përputhje me SNRF 1 “Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, bilanci i çeljes së Shoqërisë u përgatit në 1 janar 2019, data e tranzicionit në SNRF e Shoqërisë.

Ky shënim shpjegon rregullimet kryesore të bëra nga Shoqëria në riparaqitjen e pasqyrave financiare të përgatitura sipas SKK-ve, në pasqyrën e pozicionit financiar më 1 janar 2019. Nga tranzicioni në SNRF nuk janë evidentuar efekte në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, në pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

Aplikimi i përjashtimeve të adoptimit për herë të parë

SNRF 1 u lejon adoptuesve për herë të parë disa përjashtime nga zbatimi retrospektiv i disa kërkesave të SNRF-ve. Shoqëria ka zbatuar përjashtimet e mëposhtme:

- i. Aktivet dhe detyrimet financiare që ishin çregjistruar përpara datës së kalimit në SNRF në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, nuk janë njohur nën SNRF.
- ii. Shoqëria ka përdorur vlerësime sipas SNRF-ve që janë në përputhje me ato të aplikuara në bazë të SKK-ve (me rregullimin e diferencave të politikave kontabël) përveçse nëse ka evidencë objektive se ato vlerësime kanë qenë të gabuara.
- iii. Grupi vlerësoi të gjitha kontratat ekzistuese në 1 janar 2019 për të përcaktuar nëse një kontratë përmban një qira bazuar në kushtet në fuqi më 1 janar 2019. Pagesat e qirasë të shoqëruara me qira për të cilat afati i qirasë mbaron brenda 12 muajve nga data e kalimit në SNRF dhe qirat për të cilat aktiviteti themelor është me vlerë të ulët janë njohur si një shpenzim në bazë lineare gjatë afatit të qirasë ose mbi një bazë tjetër sistematike.

2 Bazat e përgatitjes dhe Deklarata e Përputhshmërisë (vazhdim)

2.2 Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë (vazhdim)

Tranzicioni në SNRF

Efektet e tranzicionit në SNRF në pasqyrën e pozicionit financiar më 1 janar 2019 paraqiten si më poshtë:

	Sipas SKK 1 janar 2019	Rregullime	Sipas SNRF 1 janar 2019
AKTIVET			
Aktivitet Afatgjata			
Aktive Afatgjata Materiale	1,817,945,876	-	1,817,945,876
Totali i Aktiveve afatgjata	1,817,945,876	-	1,817,945,876
Aktivitet afatshkurtra			
Inventar	62,207,667	-	62,207,667
Të tjera të arkëtueshme	16,560,505	(603,390)	15,957,115
Llogari të arkëtueshme	241,968,141	-	241,968,141
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	51,715,294	-	51,715,294
Totali i Aktiveve Afatshkurtra	372,451,607	(603,390)	371,848,217
TOTALI I AKTIVEVE	2,190,397,483	(603,390)	2,189,794,093
KAPITALI			
Kapitali aksionar	2,145,432,331	-	2,145,432,331
Primi i lidhur me kapitalin	43,894,151	-	43,894,151
Rezerva Rivlerësimi	37,107,467	-	37,107,467
Humbje e mbartur	(316,210,605)	(823,874)	(317,034,479)
TOTALI I KAPITALIT	1,910,223,344	(823,874)	1,909,399,470
DETYRIMET			
Detyrimet Afatgjata			
Grante dhe Të ardhura të shtyra	-	-	-
Totali detyrime afatgjata	-	-	-
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	280,174,139	220,484	280,394,623
Grante dhe Të ardhura të shtyra	-	-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra	280,174,139	220,484	280,394,623
TOTALI I DETYRIMEVE	280,174,139	220,484	280,394,623
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	2,190,397,483	(603,390)	2,189,794,093

Shoqëria ka njohur humbje të mbartura neto në përputhje me SNRF në vlerën 823,874 lekë, detyrime shtesë të pagueshme në vlerë neto në vlerë 220,484 lekë dhe zhvlerësim të llogarive të tjera të arkëtueshme në vlerë 603,390 lekë. Shoqëria nuk ka evidentuar efekte të tjera nga tranzicioni në SNRF që mund të kërkojë një korrigjim të pasqyrave financiare më 1 janar 2019.

2 Bazat e përgatitjes dhe Deklarata e Përputhshmërisë (vazhdim)

2.2 Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë (vazhdim)

Tranzicioni në SNRF (vazhdim)

Efektet e tranzicionit në SNRF në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Sipas SKK 31 dhjetor 2019	Rregullime	Sipas SNRF 31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktivet Afatgjata			
Aktive Afatgjata Materiale	2,242,252,539	-	2,242,252,539
Totali i Aktiveve afatgjata	2,242,252,539	-	2,242,252,539
Aktivet afatshkurtra			
Inventar	72,380,272	-	72,380,272
Të tjera të arkëtueshme	33,069,152	(603,390)	32,465,762
Llogari të arkëtueshme	234,742,436	-	234,742,436
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	84,092,528	-	84,092,528
Totali i Aktiveve Afatshkurtra	424,284,388	(603,390)	423,680,998
TOTALI I AKTIVEVE	2,666,536,927	(603,390)	2,665,933,537
KAPITALI			
Kapitali aksionar	2,145,432,331	-	2,145,432,331
Primi i lidhur me kapitalin	43,894,151	-	43,894,151
Rezerva Rivlerësimi	35,252,094	-	35,252,094
Humbje e mbartur	(439,402,689)	(823,874)	(440,226,563)
TOTALI I KAPITALIT	1,785,175,887	(823,874)	1,784,352,013
DETYRIMET			
Detyrimet Afatgjata			
Grante dhe Të ardhura të shtyra	485,752,464	-	485,752,464
Totali detyrime afatgjata	485,752,464	-	485,752,464
Detyrimet Afatshkurtra			
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	370,031,165	220,484	370,251,649
Grante dhe Të ardhura të shtyra	25,577,411	-	25,577,411
Totali i detyrimeve afatshkurtra	395,608,576	220,484	395,829,060
TOTALI I DETYRIMEVE	881,361,040	220,484	881,581,524
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	2,666,536,927	(603,390)	2,665,933,537

Shoqëria ka njohur humbje të mbartura neto në përputhje me SNRF në vlerën 823,874 lekë, detyrime shtesë të pagueshme në vlerë neto në vlerë 220,484 lekë dhe zhvlerësim të llogarive të tjera të arkëtueshme në vlerë 603,390 lekë. Shoqëria nuk ka evidentuar efekte të tjera nga tranzicioni në SNRF që mund të kërkojë një korrigjim të pasqyrave financiare më 1 janar 2019.

2 Bazat e përgatitjes dhe Deklarata e Përputhshmërisë (vazhdim)

2.3 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë paraqitur me vlerë të drejtë.

2.4 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në lekë.

2.5 Parimi i Vijimësisë

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon që shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale edhe në periudhat në vazhdim.

Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë e saj në vijimësi, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

Supozimet e përdorura nga drejtimi mbi gjykimet, çmuarjet dhe vlerësimet e bëra në lidhje me parimin e vijimësisë jepen në shënimin 4.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

3.1 Instrumentat financiare

Njohja dhe çregjistrimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare, fillimisht njihen në datën e tregtimit që është data në të cilën Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar çregjistrohet kur të drejtat për të marre flukse monetare kanë skaduar, ose kur aktivitet financiar i janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja e aktivitet financiar

Përveç atyre llogarive të arkëtueshme që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivitet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- me koston e amortizuar,
- vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) dhe
- vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga:

- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar dhe
- nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre.

Në gjitha në ardhurat dhe shpenzimet që lindin nga aktivitet financiare njihen në pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse, në zërin Shpenzime/ të ardhura Financiare, me përjashtim të zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme, i cili paraqitet si zë më vete i përfshirë në Fitimin/ Humbjen nga aktiviteti operativ.

i. Aktivitet financiare me koston e amortizuar

Aktivitet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të paracaktuara si VDFH):

- aktivitet financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale (“Të mbajtura për të mbledhur”) dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitet financiar japin të drejtë mbi flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar, në data të përcaktuara.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.1 Instrumentat financiare (vazhdim)

i. Aktivet financiare me koston e amortizuar (vazhdim)

Pas njohjes fillestare, ato maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlersimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar janë llogari të arkëtueshme, të tjera të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe ekuivalentë.

ii. Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH)

Aktivitet financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga “të mbajtura për të mbledhur” ose “të mbajtura për të mbledhur dhe shitur” kategorizohen me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivet financiare, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kalsifikohen në kategorinë VDFH.

Kjo kategori gjithashtu përmban edhe investimet në kapital. Aktivet në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

Shoqëria më 31 dhjetor 2020 nuk ka aktive financiare të matshme me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes.

iii. Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Shoqëria llogarit aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse VDATGJ nëse aktivet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektivi i të cilit është “mbajtja për të mbledhur dhe shitur” dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjistrimit të aktivit.

Shoqëria më 31 dhjetor 2020 nuk ka aktive financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.1 Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kredisë - 'modelin e humbjeve të pritshme të kredisë (ECL)'. Kjo zëvendëson “modelin e humbjeve të ndodhura” të SNK 39.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kredisë nuk varet më prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi bazë individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria përdor një qasje të thjeshtuar të kontabilitetit për llogaritë e arkëtueshme dhe regjistron hubjen nga zhvlerësimi si humbje të pritshme të kredisë përgjatë jetës. Këto janë humbjet e pritshme të flukseve monetare kontraktuale, duke marrë parasysh potencialin e mospagimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Për llogaritjen, Grupi përdor përvojën e tij historike.

Grupi vlerëson zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme mbi një bazë kolektive pasi ato kanë karakteristika të përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe i grupon bazuar në ditëvonesë.

Shoqëria ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2020 (shënimi 7).

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.1 Instrumentat financiare (vazhdim)

Klasifikimi dhe matja e detyrimit financiar

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Shoqërisë nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Shoqëria ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në VDPFH, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

3.2 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të parave të marra ose të arkëtueshmeve nga shoqëria për mallrat e dhëna, duke përfshirë taksat e shitjes, rabatet, dhe uljet tregtare. Shoqëria aplikon kriteret e njohjes së të ardhurave të përcaktuara si më poshtë tek çdo komponent i veçantë i transaksionit të shitjes në mënyrë që të reflektoje thelbin e transaksionit.

- 1 Identifikimi i kontratës me një klient
- 2 Identifikimi i kushteve të veçanta të një performace në një kontratë
- 3 Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- 4 Shpërndarja e çmimit të transaksionit sipas kushteve të performacës në kontratë
- 5 Njohja e të ardhurave kur një kusht performace është plotësuar.

Të ardhurat e marra nga këto transaksione janë alokuar tek komponentët e veçantë të identifikuar duke patur parasysh vlerën relative të drejtë të çdo komponenti. Të ardhurat njihen ose në një moment në kohë ose përgjatë kohës, kur (ose sipas mënyrës që) Shoqëria përmbush detyrimet e performancës duke transferuar mallrat ose shërbimet e premtuara te klientët e saj.

Shoqëria njeh detyrime kontraktuale për shumat e arkëtuara në lidhje me detyrimet e performancës të papërmbushura dhe raporton shumat të tilla si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit të pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Shoqëria përmbush një detyrim të performancës përpara se të arkëtojë, Shoqëria njeh ose një aktiv të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën e tij të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër për kalimin e detyrimit përveç kohës përpara se të bëhet pagesa.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.3 Inventaret

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre Shoqëria vlereson inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Kostot e shkaktuara në sjelljen e secilit produkt në vendndodhjen dhe gjendjen e tanishme llogariten si më poshtë: kosto direkte që lidhet me inventarët dhe ato shpenzimet e përgjithshme që kanë ndodhur në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale të tyre. Kosto e inventarit përfshin: kostoja e blerjes së mallrave, kostoja e transportit, detyrimet doganore, etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuar të kompletimit dhe kostot e nevojshme për të bërë shitjen. Drejtimi i Shoqërisë gjatë vitit monitoron periodikisht çmimet e shitjes në koston e inventarit dhe nëse çmimi ulet nën koston, diferenca njihet në Pasqyrën e Performancës si Zhvlerësim i inventarëve.

Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston mesatare. Zbritja e duhur për ulje njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

3.4 Aktivet Afatgjata Materiale

(a) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit dhe sjelljen e tij në kushtet e nevojshme për funksionim. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje.

(b) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të mirmbajtjes të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.4 Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

(c) Amortizimi/Zhvlerësimi

Pas njohjes fillestare, aktivet maten me kosto të amortizuar me metodën e vlerës së mbetur. Normat e amortizimit të zbatuara janë:

Aktive të qëndrueshme	<i>Norma Amortizimit</i>
Ndërtesa	5%
Rrjeti shpërndarës dhe Kanalizime	5%
Mjete Transporti	20%
Makineri dhe Impiante	20%
Pajisje Zyre	20%
Pajisje informatike	25%

Normat e amortizimit dhe metoda e amortizimit rishikohet çdo fund periudhe raportuese dhe nëse ka ndryshime ato aplikohen në mënyrë prospektive. Toka dhe ndërtimet në proces nuk amortizohen.

3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Për qëllime të çmuarjes së zhvlerësimit, aktivet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat gjenerohen flukse hyrëse parash të pavarura (njësi gjeneruese të parave). Si rezultat, disa aktive testohen individualisht për zhvlerësim dhe disa testohen në nivelin e njësisë gjeneruese të parave. Të gjitha aktivet individuale ose njësitë gjeneruese të parave testohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël neto mund të mos rikuperohet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivit (ose njësisë gjeneruese të parave) tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, e cila është më e larta e vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Për të përcaktuar vlerën në përdorim, drejtimi vlerëson flukset e parave të pritshme në të ardhmen nga secila njësi gjeneruese e parave dhe përcakton një normë të përshtatshme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të tyre. Të dhënat e përdorura për procedurat e testimit të zhvlerësimit janë të lidhura drejtpërdrejt me buxhetin e fundit të miratuar të Shoqërisë, të rregulluar sipas nevojës për të përjashtuar efektet e riorganizimeve dhe përmirësimeve të aktiveve në të ardhmen. Faktorët e skontimit përcaktohen individualisht për secilën njësi gjeneruese të parave dhe pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parave dhe faktorëve të rrezikut specifik.

Humbjet nga zhvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare ulin së pari vlerën kontabël të çdo emri të mirë të alokuar për atë njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Çdo humbje e mbetur nga zhvlerësimi i ngarkohet proporcionalisht aktiveve të tjera në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare. Me përjashtim të emrit të mirë, të gjitha pasuritë më pas rievlerësohen nëse ka të dhëna se një humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë mund të mos ekzistojë më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse shumat e rikuperueshme të aktivit ose njësisë gjeneruese të parave tejkalon vlerën kontabël të saj.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.6 Aktivet e marra me qira

3.6.1 Shoqëria si qiramarrëse

Shoqëria si qiramarrëse vlerëson nëse një kontratë është apo përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përcaktohet si “një kontratë, ose pjesë e një kontratë, që përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv (aktivin themelor) për një periudhë kohe në këmbim të pagesës”. Për të zbatuar këtë përkufizim, Shoqëria vlerëson nëse kontrata përmbush tre vlerësime kryesore:

- kontrata përmban një aktiv të identifikuar, i cili ose përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratë ose specifikohet në mënyrë të qartë duke u identifikuar në kohën kur aktiviteti është vënë në dispozicion të Shoqërisë
- Shoqëria ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë parasysh të drejtat e tij në qëllimin e caktuar të kontratës
- Shoqëria ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e aktivitetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Shoqëria vlerëson nëse ka të drejtë të përcaktojë ‘si dhe për çfarë qëllimi’ aktiviteti përdoret gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në pasqyrat financiare. Aktiviteti e së drejtës së përdorimit maten me kosto, e cila përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e bërë nga Shoqëria, një vlerësim i çdo kostoje për çmontimin dhe heqjen e aktivitetit në fund të qirasë, dhe çdo pagesë e qirasë bërë përpara datës së fillimit të qirasë (neto e çdo incentive të marrë).

Shoqëria amortizon aktivitetin e të drejtës së përdorimit në bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së dobishme të aktivitetit të të drejtës së përdorimit ose mbarimit të afatit të qirasë. Shoqëria gjithashtu vlerëson aktivitetin e të drejtës së përdorimit për zhvlerësim kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, Shoqëria mat detyrimin e qirasë në vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, të skontuara duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira nëse kjo normë është e disponueshme lehtësisht ose normën rritëse të huamarrjes të Shoqërisë. Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që Shoqëria do të duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë për një afat të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet për të cilat ekziston një siguri e arsyeshme se do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të ulet për pagesa të bëra të cilat alokohen në ripagesa të principalit dhe kosto financiare. Kosto financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.6 Aktivet e marra me qira (vazhdim)

3.6.1 Shoqëria si qiramarrëse (vazhdim)

Matja dhe njohja e qerave si qeramarrës (vazhdim)

Detyrimi i qirasë rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë. Ndryshimet në pagesat e qirasë mund të vijnë nga një ndryshim në afatin e qirasë ose një ndryshim në vlerësimin e një opsiioni për të blerë një aktiv me qira. Pagesat e rishikuara të qirasë zbriten duke përdorur normën rritëse të huamarrjes të Shoqërisë në datën e rivlerësimit kur norma e nënkuptuar në qira nuk mund të përcaktohet lehtë. Shuma e rimatjes së detyrimit të qirasë pasqyrohet si një rregullim i vlerës kontabël të aktivit të së drejtës të përdorimit. Si përjashtim, kur vlera kontabël e aktivit të së drejtës të përdorimit është zvogëluar në zero çdo teprice njihet në fitim ose humbje.

Pagesat e qirasë mund të ndryshojnë gjithashtu kur ka ose një ndryshim në shumat që priten të paguhesh si garanci të vlerës së mbetur ose kur pagesat në të ardhmen ndryshojnë si pasojë e një indeksi ose një norme të përdorur për të përcaktuar ato pagesa, përfshirë ndryshimet në normat e qirasë në treg pas një rivlerësimi të tregut të qirave. Detyrimi i qirasë rimatet vetëm kur rregullimi i pagesave të qirasë hyn në fuqi dhe pagesa e rishikuar e kontratës për pjesën e mbetur të afatit të qirasë skontohe duke përdorur një normë të pandryshuar skontimi.

Shoqëria ka zgjedhur të trajtojë qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur lehtësirat praktike. Në vend të njohjes së një aktivi të të drejtës së përdorimit dhe detyrimit të qirasë, pagesat në lidhje me këto njihen si një shpenzim në Pasqyrën e Fitimit ose humbjes mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

3.7 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen kundrejt provizionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

3.8 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përmbledhin të ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara në banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare të mbajtura për shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atëherë kur përdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet për interesat nga huatë, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvlerësimet e aktivave financiare. Gjithë kostot e huamarrjeve njihen në humbje fitime mbi bazën e përdorimit të metodës së interesit efektiv.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.9 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke axhustuar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga Ligji Shqiptar.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

3.10 Kapitali aksionar dhe dividendët

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lekë të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

3 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.10 Kapitali aksionar dhe dividendët (vazhdim)

Dividendët

Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të jenë autorizuar për t'u deklaruar, paraqiten në shënimin e ngjarjeve pas periudhës raportuese. Dividentët e përkohshëm zbriten nga kapitali kur ato deklarohen dhe paguhen. Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i Shoqërisë.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin e ndodhjes.

3.12 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Shoqëria nuk ka kryer transaksione në monedhë të huaj për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 dhe nuk ka aktive apo detyrime financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

3.13 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe manaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.14 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

4.1 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Shoqëria njeh detyrimin në rast të një kontrolli të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jetë i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

4.2 Inventaret

Drejtimi vlerëson vlerat neto të realizueshme të inventarëve, duke marrë parasysh evidencën më të besueshme në dispozicion në çdo datë raportimi. Realizimi në të ardhmen i këtyre inventarëve mund të ndikohet nga teknologjia e ardhshme ose ndryshime të tjera të drejtuara nga tregu që mund të ulin çmimet e shitjes në të ardhmen.

4.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vjueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikuar.

4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

4.3 Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit që COVID-19 paraqiti për shëndetin publik, në 12 mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë ndërmorën masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme. Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përjashtuar shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu udhëzuan punonjësit të qëndronin në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Ndikimet më të gjera ekonomike të këtyre ngjarjeve përfshijnë:

- Ndërprerje në operacionet e biznesit dhe aktivitetin ekonomik në Shqipëri, me një ndikim bllokues në zinxhirët e furnizimit të brendshëm;
- Ndërprerje e konsiderueshme për bizneset në sektorë të caktuar, si brenda Shqipërisë, ashtu edhe në tregjet me varësi të lartë nga një zinxhir i furnizimit të huaj, si dhe bizneset e orientuara nga eksporti me mbështetje të lartë në tregjet e huaja. Sektorët e prekur përfshijnë tregtinë dhe transportin, udhëtimin dhe turizmin, argëtimin, prodhimin, ndërtimin, shitjen me pakicë, sigurimet, arsimin dhe sektorin financiar;
- Ulje e konsiderueshme e kërkesës për mallra dhe shërbime jo thelbësore;
- Një rritje në pasigurinë ekonomike, e reflektuar në më shumë çmime të paqëndrueshme të pronave dhe kursit të këmbimit të valutave.

Shoqëria si objekt aktiviteti të saj ka ofrimin e të mirave publike siç janë furnizimi me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemit të furnizimit të ujit të pijshëm, shërbimi i grumbullit, largimit dhe trajnimit të ujërave të ndotura dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre dhe për pasojë aktiviteti i saj nuk është ndërprerë as në kushtet e pandemisë dhe shitjet e shoqërisë nuk janë impaktuar prej saj.

Bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht, në datën kur këto pasqyra financiare ishin të autorizuar për dorëzim, Drejtimi konsideroi një numër skenarësh të besueshme në lidhje me zhvillimin e mundshëm të Covid-19 dhe ndikimin e tij të pritshëm në njësinë ekonomike dhe mjedisin ekonomik në të cilin njësia ekonomike operon, përfshirë masat që pritet të merren nga qeveria. Drejtimi konsideroi faktin që njësia ekonomike operon në sektorin e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe nuk pritet të ketë kufizime shtesë apo ndalim të aktivitetit tregtar gjatë 2021.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 shoqëria rezultoi me humbje neto 123,143,715 lekë (31 dhjetor 2019: 124,558,064 lekë). Më 31 dhjetor 2020 aktivet afatshkurtra të shoqërisë tejkalojnë detyrimet afatshkurtra me 30,193,316 lekë (31 dhjetor 2019: 27,851,938 lekë). Në bazë të planit financiar të aprovuar për Shoqërinë në vitet e ardhshme Shoqëria parashikon të rrisë aktivitetin e saj operacional dhe parashikohet që në vitet e ardhshme të jetë me rezultat pozitiv. Përveç sa më sipër aksionarët e shoqërisë kanë marrë angazhim që do të mbështesin shoqërinë me financime, në rast se kjo do të jetë e nevojshme.

4. Gjkime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

4.3 Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Si rrjedhojë, drejtimi parashikon që Shoqëria do të ketë burimë të mjaftueshme për të siguruar vijueshmërinë e biznesit për një periudhë të paktën 12 muaj nga data e raportimit. Drejtimi i shoqërisë nuk është në gjendje të parashikojë të gjitha zhvillimet që mund të kenë një ndikim në sektorin e ekonomisë dhe më gjerë, dhe rrjedhimisht çfarë efekti do të kenë (nëse do të kenë) në pozicion financiar të shoqërisë në të ardhmen.

“Ujesjelles - Kanalizime Elbasan” sh.a
Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare
Më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020
(të gjitha shumat janë në lekë, përveç se kur është shprehur ndryshe)

5 Aktivet Afatgjata Materiale

Aktivët Afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Toka	Ndërtesa	Rrjeti shpërndarës & kanalizime	Makinieri dhe impiante	Mjete Transporti	Pajisje Zyre dhe informatike	AAM në proces	Totali
Kosto								
Më 31 dhjetor 2018	18,867,322	248,655,657	1,706,182,423	143,887,093	-	65,628,723	-	2,183,221,218
Riklasifikim për aplikimin fillëstar të SNRF-ve	-	-	(19,585,606)	(5,374,455)	24,960,061	-	-	-
Më 1 janar 2019	18,867,322	248,655,657	1,686,596,817	138,512,638	24,960,061	65,628,723	-	2,183,221,218
Shtesa	-	-	514,412,821	3,494,000	-	3,570,610	-	521,477,431
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	18,867,322	248,655,657	2,201,009,638	142,006,638	24,960,061	69,199,333	-	2,704,698,649
Shtesa	-	-	32,043,081	58,306,765	-	1,355,297	13,333,333	105,038,476
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	18,867,322	248,655,657	2,233,052,719	200,313,403	24,960,061	70,554,630	13,333,333	2,809,737,125
Amortizimi i akumuluar								
Më 31 dhjetor 2018	-	(34,616,470)	(239,776,072)	(58,354,558)	-	(32,528,242)	-	(365,275,342)
Riklasifikim për aplikimin fillëstar të SNRF-ve	-	-	(8,724,086)	22,763,737	(14,039,651)	-	-	-
Më 1 janar 2019	-	(34,616,470)	(248,500,158)	(35,590,821)	(14,039,651)	(32,528,242)	-	(365,275,342)
Amortizimi i periudhës	-	(10,701,959)	(72,951,480)	(4,317,026)	(2,184,082)	(7,016,221)	-	(97,170,768)
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	-	(45,318,429)	(321,451,638)	(39,907,847)	(16,223,733)	(39,544,463)	-	(462,446,110)
Amortizimi i periudhës	-	(10,166,861)	(94,035,367)	(6,637,097)	(1,747,266)	(5,679,115)	-	(118,265,706)
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	-	(55,485,290)	(415,487,005)	(46,544,944)	(17,970,999)	(45,223,578)	-	(580,711,816)
Vlera neto kontabël								
Më 31 dhjetor 2019	18,867,322	203,337,228	1,879,558,000	102,098,791	8,736,328	29,654,870	-	2,242,252,539
Më 31 dhjetor 2020	18,867,322	193,170,367	1,817,565,714	153,768,459	6,989,062	25,331,052	13,333,333	2,229,025,309

6 Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	78,395,840	70,159,116
Materiale Ndihmëse dhe Lëndë Djegëse	37,644,850	214,664
Inventar i Imet	946,717	946,717
Mallra	847,028	1,059,775
Totali	117,834,435	72,380,272

7 Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme për Dëmshtëpërblime (Albstar, BWI)	19,862,609	19,862,609
TVSh e Arkëtueshme	6,562,119	-
Taksë përmbartimore	1,915,405	2,075,404
Arketimet nga posta	1,807,475	2,285,477
Arketime nga Wester Union	148,805	-
Arketime nga Easy PAY	104,854	64,851
Arketime nga AK Invest	82,445	125,391
Të tjera të arkëtueshme	8,114,440	8,052,030
Totali	38,598,152	32,465,762

8 Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten në bilanc me vlerën e tyre të drejtë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme deri në një vit	107,059,987	89,443,471
Të arkëtueshme mbi një vit	445,674,474	431,228,617
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(314,169,411)	(285,929,652)
Totali	238,565,050	234,742,436

8 Llogari të arkëtueshme (vazhdim)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Gjendja më 31 dhjetor 2018		94,961,770
Korigjim Zhvlerësimi për vitet e kaluara	-	164,755,270
Gjendja më 1 janar	285,929,652	259,717,040
Shpenzimi i periudhës	28,239,759	26,212,612
Gjendja më 31 dhjetor	<u>314,169,411</u>	<u>285,929,652</u>

Llogaritë e arkëtueshme të grupuara sipas llojit të konsumatorëve më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Familjarë të vitit	89,629,446	75,873,422
Familjarë mbi një vit	398,703,557	390,489,468
Biznese të vitit	13,805,766	12,999,480
Biznese mbi një vit	45,669,921	39,723,539
Institucione të vitit	3,624,775	570,569
Institucione mbi një vit	1,300,996	1,015,610
Totali	<u>552,734,461</u>	<u>520,672,088</u>

9 Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Para në Bankë	68,873,825	84,092,528
Para në arkë	7,420	-
Totali	<u>68,881,245</u>	<u>84,092,528</u>

10 Kapitali aksionar

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2020 në shumën 2,145,432,331 lekë (31 dhjetor 2019: 2,145,432,331 lekë) zotërohet 100% nga Bashkia Elbasan. Kapitali aksionar përbëhet nga 1 aksion me vlerë nominale të aksionit 2,145,432,331 lekë.

11 Grante dhe Të ardhura të shtyra

Grante dhe Të ardhura të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Grante Afatshkurtër	273,886	25,577,411
Grante Afatgjatë	598,010,327	485,752,464
Totali	598,284,213	511,329,875

Lëvizja në Grante dhe Të ardhura të shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Gjendja më 1 janar	511,329,875	-
Grante të arkëtuara për vitin	120,864,154	532,100,899
Grante të marra në të ardhura	(33,909,816)	(20,771,024)
Gjendja më 31 dhjetor	598,284,213	511,329,875

12 Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)	369,400,223	330,562,465
Të pagueshme tregtare	30,439,762	7,694,535
Të pagueshme për Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	3,765,723	3,534,860
Detyrime Tatimore	496,330	826,404
Enti Rregullator i Ujit (ERU)	4,854,000	1,200,000
Taksa të Bashkisë të arkëtuara nga UKE	20,187,935	15,898,794
Detyrime Akt Kontrolli Tatimor	-	6,271,074
Të tjera të pagueshme	4,267,707	4,263,517
Totali	433,411,680	370,251,649

13 Të ardhura nga shitja

Të ardhura nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Të ardhura nga shitja e ujit	340,945,350	339,625,606
Vendosje matësi	2,407,856	803,871
Lidhje, rilidhje uji	1,428,623	2,218,100
Klientë për Prerje dhe Rilidhje	670,167	662,669
Klientë për tarifa	420,915	436,000
Miratim planvendosje	384,000	457,833
Të ardhura të tjera	5,510	-
Totali	346,262,421	344,204,079

14 Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar

Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar më 31 dhjetor 2020 në vlerë 2,292,546 lekë (31 dhjetor 2019: 2,751,945 lekë) përfaqëson investimet e kryera nga shoqëria në rrjetet e shpërndarjes dhe kanalizime.

15 Të ardhura të tjera operative

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Të ardhura nga kamatat	10,071,210	10,791,619
Të ardhura nga tarifa e grumbullimit taksës	6,081,139	4,869,580
Të ardhura të tjera operative	366,927	80,232
Gjoha dhe penalitete të arkëtuara	105,000	-
Totali	16,624,276	15,741,431

16 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Shpenzime materiale të para	17,073,476	11,198,326
Shpenzime Materialë ndihmës	1,597,479	520,000
Shpenzime Lëndë djegëse	2,793,006	1,886,405
Totali	21,463,961	13,604,731

17 Shpenzime energjie elektrike

Shpenzime energjie elektrike për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 në vlerën 119,501,512 lekë (31 dhjetor 2019: 140,974,243 lekë) përfaqësojnë shpenzimet e energjisë për funksionimin e rrjetit të furnizimit dhe shpërndajës së ujit të pijshëm, shpenzimet për funksionimin e rrjetit të kanalizimeve dhe shpenzime energji për administratën dhe të tjera.

18 Shpenzime të tjera operative

Shpenzime të tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Blerje uji	862,440	908,910
Shërbime Auditimi dhe Avokatie	1,236,000	1,350,000
Shërbim printimi dhe mirëmbajtje	1,313,101	3,022,191
Qira	399,996	1,173,996
Mirëmbajtje Automjesh	3,401,633	1,072,000
Mirëmbajtje të tjera	153,800	157,200
Mirëmbajtje për Makineri dhe Impiante	1,840,000	910,500
Riparim rrugë	2,057,118	-
Prime Sigurimi	602,900	599,538
Kërkime dhe studime	-	438,837
Personel jashtë njësisë	981,418	1,155,674
Shpenzime për ruajtje	20,266,779	19,514,571
Shpenzime marketing	12,500	35,000
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	1,644,910	1,639,043
Shpenzime transporti	920,040	792,800
Shpenzime për shërbimet bankare	125,931	96,765
Shpenzime përmbarimi	1,540,340	4,849,918
Taksa dhe tarifa vendore	5,851,409	5,317,744
Taksa e regjistrimit	4,144,271	532,003
Gjoha dhe dëmshpërblime	589,413	6,340,036
Shpenzime të tjera	2,029,299	779,945
Shpenzime të panjohura	120,600	-
Totali	50,093,898	50,686,671

Tarifa e Auditimit Ligjor është 1,236,000 lekë pa TVSh, vlerë e cila përfshihet në shpenzime Auditimi dhe Avokatie.

19 Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</i>	<i>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</i>
Shpenzime për paga dhe shpërblime	133,325,664	130,083,796
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	26,307,283	25,556,972
Shpenzime të tjera për personelin	24,006,900	22,973,854
Antidode	1,029,600	765,900
Totali	184,669,447	179,380,522

20 Tatimi mbi Fitimin

Shoqëria ka rezultuar me humbje për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 dhe nuk ka llogaritur tatim mbi fitimin. Llogaritja e humbjes fiskale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<i>Viti 2020</i>	<i>Viti 2019</i>
Humbje para tatimit	(123,143,715)	(124,558,064)
<i>Shpenzime të panjohura</i>		
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	28,239,759	26,212,612
Gjoba dhe dëmshpërblime	1,929,753	11,189,954
Shpenzime të tjera të panjohura	120,600	-
Humbja fiskale	(92,853,603)	(87,155,498)

21 Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një person apo një entitet që ka kontroll apo kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë, ka aftësinë të ushtrojë influencë të konsiderueshme mbi Shoqërinë në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, është anëtar i personelit të drejtimit kyç të Shoqërisë apo të një Shoqërie mëmë të Shoqërisë, si dhe është pjesë e të njëjtit grup me Shoqërinë, është filial, investim në pjesmarrje apo apo shoqëri mbi të cilën Shoqëria ushtron kontroll apo influencë të konsiderueshme. Gjithashtu konsiderohet palë e lidhur një shoqëri që ka një sipërmarrje të përbashkët me Shoqërinë apo dy entitete të cilat janë sipërmarrje të përbashkëta të një shoqërie të tretë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndermarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut.

21 Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktive		
Llogari të Arkëtueshme		
<i>Bashkia Elbasan</i>	67,766	23,504
Detyrime		
Llogari të pagueshme		
dhe të tjera të pagueshme		
<i>Bashkia Elbasan</i>	20,187,935	15,898,794
	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>
Të Ardhura		
Të ardhura nga shitja		
<i>Bashkia Elbasan</i>	3,485,112	3,581,432
Shpenzime		
Shpenzime të tjera operative		
<i>Bashkia Elbasan</i>	5,851,409	5,317,744
<i>Shpërblime për organet drejtuese</i>	2,348,476	2,763,673

22 Ngjarjet pas bilancit

Nuk ka pasur asnjë ngjarje pas datës së raportimit, e cila kërkon dhënie informacioni shtesë apo ndonjë rregullim në pasqyrat financiare.

23 Manaxhimi i rrezikut financiar

23.1 Faktorët e rrezikut financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të rrezikut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e rrezikut. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve. Shoqëria gjatë aktivitetit të saj ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- 1) Rreziku i kredisë
- 2) Rreziku i tregut
- 3) Rreziku i likuiditetit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, si dhe politikat dhe procedurat për administrimin e këtyre risqeve.

23.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku që një palë tjetër nuk arrin të përmbushë një detyrim ndaj Shoqërisë. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nga aktivet financiare përfshirë mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre të mbajtura në banka, llogari të arkëtueshme dhe të tjera.

Aktivitet financiarë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë detajuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	68,881,245	84,092,528
Llogari të arkëtueshme (bruto)	552,734,461	520,672,088
Të tjera të arkëtueshme	32,036,033	32,465,762
Totali	<u>653,651,739</u>	<u>637,230,378</u>

Shoqëria

23.3 Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut përbëhet nga rreziku i luhatjes së kurseve të këmbimit dhe rreziku i luhatjes së normave të interesit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Shoqëria nuk kryen transaksione në monedha të huaja dhe për pasojë nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit

Politika e Shoqërisë është të minimizojë ekspozimet ndaj rrezikut të normave të interesit për financimin afatgjatë. Shoqëria nuk ka investime financiare apo huamarrje që ta ekspozojnë atë ndaj rrezikut të normave të interesit.

23 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

23.4 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës.

<i>31 dhjetor 2020</i>	<i>deri në 3 muaj</i>	<i>3 muaj - 1 vit</i>	<i>mbi 1 vit</i>	<i>Totali</i>
Aktive				
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	68,881,245	-	-	68,881,245
Llogari të arkëtueshme	238,565,050	-	-	238,565,050
Të tjera të arkëtueshme	32,036,033	-	-	32,036,033
Totali Aktive Financiare	339,482,328	-	-	339,482,328
Detyrime Financiare				
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	432,915,350	-	-	432,915,350
Totali Detyrime Financiare	432,915,350	-	-	432,915,350
Pozicioni Neto	(93,433,022)	-	-	(93,433,022)

<i>31 dhjetor 2019</i>	<i>deri në 3 muaj</i>	<i>3 muaj - 1 vit</i>	<i>mbi 1 vit</i>	<i>Totali</i>
Aktive				
Mjete Monetare dhe ekuivalentë	84,092,528	-	-	84,092,528
Llogari të arkëtueshme	234,742,436	-	-	234,742,436
Të tjera të arkëtueshme	32,465,762	-	-	32,465,762
Totali Aktive Financiare	351,300,726	-	-	351,300,726
Detyrime Financiare				
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	363,154,171	-	-	363,154,171
Totali Detyrime Financiare	363,154,171	-	-	363,154,171
Pozicioni Neto	(11,853,445)	-	-	(11,853,445)